

DIPLOMA

Kodi i lëndës	Semestr i	Kreditet e lëndës				Kredite
		Leksione	Ushtrime/ Seminare	Laboratore	Diploma	
B-TLK-360	VI	-	-	-	6	6
Sasia e orëve: auditor/ jashtë auditorit		-	-	-	60/90	60/90
Sasia e orëve: Total		-	-	-	150	150

Objektivat

Punimi i diplomës ka për qëllim të ofrojë, për studentët në fushën e inxhinierisë së telekomunikacionit, një kulturë bazë inxhinierike të sistemeve të telekomunikacioneve dhe protokolleve të transmetimit të të dhënave. Gjithashtu ka për qëllim që i diplomuari të brumoset me të menduarit kritik në mënyrë që të mos shikojë vetëm aspektet e projektimit të sistemeve të telekomunikacioneve apo elementeve të tyre përbërës, por edhe ato të dimensionimit dhe menaxhimit optimal të tyre. Përsa i përket formimit në fushën e mirëfilltë të inxhinierisë së telekomunikacionit punimi i diplomës ofron njohuri mbi arkitekturën e sistemeve të telekomunikacioneve; teknikave të përpunimit dhe transmetimit të sinjaleve multimediale, audio, video; teknikave numerike të transmetimit që lidhen me sistemet wireless, sistemet satelitore, sistemet me fibra optike; arkitekturën e rrjetave dhe protokolleve të transmetimit të të dhënave.

Njohuritë dhe aftësitë që përftohen nga përvetësimi i diplomës

Diploma zhvillohet në semestrin e dytë, në vitin e tretë, pranë laboratoreve të departamentit, ose pranë kompanive, institucioneve apo organizatave, aktiviteti i të cilave mbështetet në teknologjitë e lidhura me fushën e telekomunikacioneve.

Me fitimin e krediteve të saj studenti duhet të jetë i aftë:

Të merret me projekte, zbatime dhe mirëmbajtje të sistemeve përpunues të informacionit, të sistemeve të telekomunikacioneve, si dhe rrjetave të transmetimit të të dhënave.

Të drejtojë sistemet e transmetimit të të dhënave të ndërmarrjeve, apo kompanive që punojnë në fushën e telekomunikacioneve.

Të merret me aktivitete të promovimit, shitjes, asistencës teknike dhe të profesionistit të lirë në inxhinieri telekomunikacioni.

Të përdorë njohuritë e marra në shkollë, për përdorimin e tyre efikas në sistemet praktike të lidhura me sistemet e telekomunikacioneve, rrjetat e telekomunikacioneve, protokollet e transmetimit të të dhënave, protokollet e komunikimit, implementimin e rregullave/protokolleve të sigurisë së informacionit.

Të kryejë analizën teorike/analitike të problemeve dhe interpretimin e fenomeneve që lidhen me ecurinë dhe përpunimin e sinjaleve në sistem dhe mjedisin e transmetimit.

Diploma e Ciklit të Parë "Bachelor" i jep mundësinë mbajtësit të saj për vazhdimin e studimeve në programet e ciklit të dytë (studimet master i shkencave ose master profesional).

Për të vazhduar studimet në programet e ciklit të dytë, master i shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni dhe në fusha të afërta me të, kandidati preferohet të ketë fituar notën mesatare të ponderuar: 7 (shtatë) deri në 10 (dhjetë).